

# **STATUTI I PARTISË SË GJELBËR**



# **PARTIA E GJELBËR**

**Miratuar në Kongresin e trete të Partisë së Gjelbër  
13 Dhjetor 2011**

## **HYRJE**

Partia e Gjëlber është krijuar në qytetin e Tiranës më date 1 Shtator 2001, me dëshirën e përpashkët për të krijuar një force politike me parime të gjëlbera ekologjike, demokratike, sociale dhe paqësore.

## **EMËRI DHE SELIA**

### **Neni 1**

Emëri i Partisë është **Partia e Gjëlber**

“Selia e Partisë ndodhet në: Rrugën; Bulevardi Bajram Curri, Pall.3, Shk.1, Ap.4.

## **DETYRAT DHE QËLLIMI**

### **Neni 2**

P.Gj, përfaqëson interesat politike, ekonomike e sociale të shtresave të gjëra të popullsisë, intelektualeve, punonjësve, të rinjëve, studentëve dhe nxënësve që përfaqësojnë alternativën e saj programore për politikën e mbrojtjes së ambientit, identitetit kulturor, traditave shekullore dhe zhvillimin e politikave të gjëlbera. Për realizimin e programit të P.Gj, ajo organizohet dhe punon në bazë të normave të saj të brendshme të shprehura në këtë statut.

Në veprimtarinë e saj P.GJ, respekton Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

## **ANTARËSIMI NË PARTI**

### **Neni 3**

**3.1** Antar i P.GJ, mund të jetë çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë, pa dallim kombësie, race, seksi, gjendje ekonomike, shtrese shoqërore dhe bindje fetare i cili ka mbushur moshën 18 vjec, pranon progra-statutin e Partisë dhe punon për zbatimin e tij.

**3.2** Antarësia në P.GJ, është vullnetare.

**3.3** Pranimi i antarit në Parti bëhet individualisht dhe sipas kërkesës personale.

**3.4** Vendimi për pranimin e tij merret nga mbledhja e seksionit dhe hyn në fuqi menjëherë. Antari i Partisë paiset me dokumentin e antarësisë.

## **DETYRAT DHE TË DREJTAT E ANTARIT TË PARTISË**

### **Neni 4**

**4.1** Antari i P.GJ, detyrohet :

- Të bëj pjesë në një seksion të Partisë së Gjëlber
- Të paguaj rregullisht kuotizacionin e antarësisë.
- Të mos bëjë pjesë në parti të tjera politike shqiptare, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

#### **4.2 Antari P.GJ, ka të drejtë :**

- Të marrë pjesë, nëpërmjet mbledhjeve, shtypit e formave të tjera, për përpunimin, zbërthimin dhe zbatimin e politikës së P.GJ, të programit dhe statutit të saj.
- Të zgjedh dhe të zgjidhet në organet drejtuese të partisë.
- Të njihet, nëpërmjet mbledhjeve, shtypit dhe formave të tjera, me veprimtarinë e organeve drejtuese të Partisë dhe të bëjë vlerësime për punën e tyre.
- Të propozoj dhe të propozohet kandidat përfaqësues i Partisë në organet e pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv.
- Të njihet me veprimtarin e përfaqësuesve të Partisë në organet e pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv dhe të bëjë vlerësime për punën e tyre.
- Të jetë i pranishëm në rastet kur në organizatën e Partisë diskutohen vërejtje dhe propozime që ai ka bërë.
- Të jetë i pranishëm në mbledhjen e organit drejtues të Partisë që merr një vendim lidhur me veprimtarin e tij.
- Të mbrohet nga Partia kur ai sulmohet dhe persekutohet për bindjet e tij politike.
- Të bëjë pjesë e të inicoje krijimin e organizatave, shoqatave, fondacioneve e të forumeve të tjera, veprimtaria e të cilave ndërtohet në përputhje me ligjet e republikës së Shqipërisë dhe nuk është në kundërshtim me programin e P.GJ
- Të ankohet në organet drejtuese të Partisë, kur nuk është dakort me qëndrimin e mbajtur ndaj tij nga ana e seksionit.
- Të largohet nga partia me dëshirën e tij dhe pa detyrim për të dhënë shpjegime.

**4.3** Antarët e P.GJ, janë të barabart midis tyre, pavarësisht nga funksionet që kanë brënda saj, gjendjes ekonomike dhe pozicionit shoqëror jashtë saj.

### **NDËRPRERJA E PËRKOSSHME E ANTARËSISË DHE LARGIMI NGA PARTIA.**

#### **Neni 5**

**5.1** Në rast se antari i P.GJ për arsye shëndetësore ose për arsye punësimi të përkoshëm jashtë shtetit, nuk përballon dotë angazhimet partiake, seksioni vendos ndërprerjen e përkoshëm të antarësisë dhe e liron nga detyrimet përkatëse.

**5.2** Në rast se antari i P.GJ, punësohet në sektorë në të cilat pjesëmarrja në Parti politike ndalohet me ligj, atëherë seksioni ku bënë pjesë e liron nga detyrimet përkatëse, bënë rregjistrimin përkatës dhe njofton Këshillin Drejtues të Degës së Partisë.

**5.3** Kur me kërkesë të tij, antari i Partisë largohet prej saj, seksioni i Partisë bënë rregjistrimin dhe njofton Këshillin Drejtues të Degës së Partisë.

**5.4** Ndaj antarit të Partisë që shkel vendimet e forumeve të saj, cënon normat shoqërore që burojnë nga Programi dhe Statuti i Partisë, nuk paguan kuotizacionin e antarësisë, mungon në mbledhjen e seksionit ose në forumin ku është zgjedhur pa arsye për më shumë se gjashtë muaj dhe me veprimtarin e tij nuk justifikon qënien në parti ose në organet e saj drejtuese, sipas shkallës së përgjegjësisë, merren këto masa :

**a.**-Këshillim

**b.**-Shkarkim nga organet e zgjedhura partiake.

c.-Crregjistrim nga Partia.

**5.5** Vendimin për crregjistrimin nga Partia e merr seksioni përkates, me inisiativen e tij ose me propozim të një organi drejtues. Ai hyn në fuqi pasi miratohet nga Kryesia e Këshillit Drejtues të Degës së Partisë së Qarkut.

**5.6** Shkarkimi nga detyra dhe crregjistrimi nga Partia i Antarit të Këshillit Drejtues të Degës së Partisë së qarkut ose i Këshillit të Përgjithshëm Drejtues vendoset nga organi ku ai është i zgjedhur.

## **STRUKTURA ORGANIZATIVE E PARTISË**

### **Neni 6**

#### **6.1 Seksioni është njësia themelore organizative e Partisë së Gjellbër.**

Formohet nga jo me pak se tre antarë partie.

Ngrihet sipas vëndbanimit në bazë rajoni apo lagje qyteti, fshati ose grupi banesash. Mblidhet jo me rrallë se një herë në tre muaj me kërkesën e kryetarit të saj ose të degës zonale, të Kryesisë së P.GJ të Degës së qarkut si dhe me kërkesën e një të tretës të antarëve të saj.

Në mbledhjen dhe veprimtarit e seksionit të Partisë mund të ftohen të marrin pjesë edhe përkrahës ose mbështetës të P.GJ.

**6.2** Për drejtimin e punëve të përditëshme, seksioni zgjedh Kryetarin dhe një Sekretar. Mbledhjen për analizën e veprimtarisë së përgjithshme dhe zgjedhjet e zhvillon, si rregull një here në tre vjet, në prag të konferencës së Partisë së Degës së qarkut.

#### **6.3 Seksioni ka këto detyra kryesore :**

- Të marre pjesë në përpunimin e zbërthimin dhe zbatimin e politikës së P.GJ-së, të programit të saj dhe të statutit.
- Të përpunoj, zbërthej dhe zbatoje politikën e P.GJ-së, bazuar në programin, statutin dhe vendimet e organeve drejtuese, në kushtet konkretet të teritorit ku ajo vepron.
- Të mbaj dhe të zhvilloj lidhje me përkrahsin e P.GJ-së.
- Të zgjeroj ndikimin e P.GJ-së, në shtresat e ndryshme të shoqërisë.
- Të mbaje lidhjet me organizmat publike, shoqatat e forca të tjera politike në teritorin ku ajo vepron, në përputhje me programin dhe objektivat e P.GJ.
- Të mbajë qëndrim ndaj cilitdo antari të saj që shkel ligjet e Republikës së Shqipërisë, si dhe normat që shprehen në këtë Statut dhe në Programin e Partisë.

## **DEGA LOKALE**

### **Neni 7**

**7.1** Drejtimin operativ të bashkimitë së seksioneve të Partisë e kryen Dega Lokale.

## **7.2 Dega Lokale**

- Ngrihet mbi bazë bashkie dhe në bazë komune.
- Drejtimin e punës e benë Kryesia e Këshillit Drejtues të Degës Lokale dhe Këshilli Drejtues i saj.
- Këshilli Drejtues i Degës Lokale përbehet nga Kryetarët e seksioneve dhe të zgjedhurve të cilët propozohen nga Kryesia e Degës në Qarkut dhe zgjidhen nga Këshillit Drejtues i Degës Lokale. Numëri i tyre përcaktohen sipas nevojave nga Kryesia e Degës në Qark.
- Këshilli Drejtues i Degës Lokale zgjedh Kryetarin, Kryesinë dhe Sekretarët.
- Mblidhet jo me rrallë se një herë në tre muaj, me kërkesë të kryetarit të saj, ose të kryesisë së P.GJ të Degës së Qarkut, si dhe 1/3 së antarëve të Deges Lokale.

## **7.3 Dega Lokale ka këto detyra :**

- Të mbaj lidhje ndërmjet seksioneve dhe Këshillin Drejtues të Partisë të Degës së Qarkut.
- Të ndjek veprimtarine e seksioneve, pranimet e reja dhe problemet e tjera që lidhen me jetën e brëndëshme të Partisë.
- Organizon e kordinon punën e Partisë në zonë për të gjitha problemet politike, ekonomike e shoqërore, duke bashkëpunuar për këtë qëllim me grupet e këshilltarëve të Partisë të zonës ku vepron.
- Jep mendimin për kandidatet e zonës për në organet e tjera Drejtuese të Partisë.

**7.4** Për drejtimin e veprimtarisë së saj Dega Lokale zgjedh Kryesinë, Kryetarin dhe Sekretarët e saj.

## **ORGANET DREJTUESE LOKALE**

### **Neni 8**

**8.1** Organi kryesor drejtues i Partisë së Degës në Qark është Konferenca e Partisë së Qarkut.

**8.2** Konferenca e Degës së Partisë në Qark mblidhet jo me rrallë se një herë në tre vjet me vendim të Këshillit Drejtues të Partisë së Degës të Qarkut ose me kërkesë të Kryesisë së P.GJ-së, së Qarkut, si dhe jo me pak se 1/3 e antaresisë së plotë të K.D.

**8.3** Konferenca e Partisë së Degës së Qarkut, zgjedh Këshillin Drejtues të Degës së Partisë të Qarkut dhe Kryetarin. Numrin e antarëve të Këshillit Drejtues e përcakton Konferenca. Numri i antareve të K.D të caktuar drejtëpërdrejtë (pa zgjedhje nga Konferenca) nuk duhet të arrij 1/3 e antaresisë së plotë të K.D.

**8.4** Kryetarët e Degëve Lokale, Kryetari i F.R.GJ-të Degës së Qarkut dhe Kryetarja e F.G.GJ, të Degës së Qarkut caktohen drejtëpërdrejt antarë të Këshilli Drejtues të Degës së Qarkut.

**8.5** Konferenca e Qarkut zgjedh delegatët për në Kongresin e Partisë dhe propozon, kandidat për Antarë të Këshillit të Përgjithshëm Drejtues të Partisë.

**8.6** Këshilli Drejtues i Degës së Qarkut drejton veprimtarinë e P.GJ. të Degës së Qarkut ndërmjet dy Konferencave.

**8.7** Këshilli Drejtues i Degës së Partisë së Qarkut, me votim të fshehtë e me disa kandidatë, zgjedh Kryesinë e Këshillit Drejtues të Degës së Qarkut dhe Sekretarët. Numrin e antarëve të kryesisë e përcakton Këshilli Drejtues i Qarkut.

**8.8** Këshilli Drejtues i degës së Qarkut mblidhet jo më rrallë se një herë në tre muaj, me kërkesë të Kryesisë ose të Kryetarit të Partisë të Degës së qarkut, të jo me pak se 1/3 antarëve të tij, si edhe të kryesisë së P.GJ-së.

**8.9** Për probleme të një rëndësie të vecante mblidhen edhe aktive të Partisë së Degës në Qark

### **Këshilli Drejtues i Partisë në Qark**

- Këshilli Drejtues i Degës së Qarkut drejton veprimtarinë e P.GJ. të Degës së Qarkut ndërmjet dy Konferencave.
- Punon dhe përgjigjet për zbatimin në Qark të programit, të statutit dhe të vendimeve të konferencës së qarkut e të organeve drejtuese qendrore të Partisë.
- Udhëzon, ndihmon dhe kontrollon seksionet dhe degët Lokale në veprimtarinë e tyre politike.
- Shpërndan fondet e Partisë brënda Qarkut, administron dhe kontrollon mbledhjen e kuotizacioneve, arkën, aktivitetin ekonomik dhe pasuritë e tjera të Partisë dhe zbatimin e rregullave për përdorimin e tyre
- Këshilli Drejtues i Degës së Partisë së Qarkut, me votim të fshehtë e me disa kandidatë, zgjedh Kryesinë e Këshillit Drejtues të Degës së Qarkut dhe Sekretarët. Numrin e antarëve të kryesisë e përcakton Këshilli Drejtues i Qarkut.
- Këshilli Drejtues i Degës së Partisë së Qarkut ka të drejtë, që me propozim të 1/3 të antarëve të tij, të kërkojë votbesimim për kryetarin e Partisë së Qarkut.
- Të gjitha votat brënda Këshillit Drejtues i Degës së Partisë së Qarkut zënë vënd me 2/3 e mazhoritetit të votave të votuesve prezente.

### **Kryesia e Këshillit Drejtues të Degës së Partisë të Qarkut**

- Punon dhe përgjigjet për plotësimin e detyrave të caktuara nga Këshilli Drejtues i Degës së qarkut dhe nga organet drejtuese qendrore.
- Organizon dhe miraton ngritjen e struktureve organizative në Qark
- Vendos për krijimin e seksioneve të tjera të Partisë.
- Përgjigjet për ruajtjen dhe administrimin e materialeve dokumentare të Partisë në administratën e Këshillit dhe pranë seksioneve të Partisë.
- Raporton për veprimtarinë e saj në organizatat e Partisë, në Konferencat e Partisë së Qarkut, në K.P.D të Partisë dhe në Kryesinë e tij.
- Propozon në K.D.Qarkut, antarët e rinjë që do të zgjidhen (koptohen)

Kryesia e Këshillit Drejtues të Partisë të Qarkut ,në frymën e normave të këtij statuti dhe për të lejuar funksionimin e saj në ekip,përcakton ndarjen e punëve e të përgjegjësive për Kryetarin dhe Sekretarët,që ndjekin zbatimin e përditshëm të detyrave dhe për antarët e tjere të saj.Ky organizëm përcaktohet në rregulloren e brendëshme dhe për të informohet Këshilli Drejtues i Degës së Qarkut.

## **ORGANET DREJTUESE QËNDRORE**

### **Neni 9**

#### **Organet drejtuese qendrore të Partisë janë:**

**Kongresi**

**Kryetari**

**Këshilli i Përgjithshëm Drejtues**

**Kryesia**

**Komiteti i Ndërmjetës**

**Grupi Monitorues Financiar**

## **KONGRESI**

### **Neni 10**

#### **10.1 Organi Drejtues më i lartë i P.GJ-së, është Kongresi i Partisë.**

Kongresi i Partisë analizon veprimtarinë e saj gjate periudhes ndërmjet dy Kongreseve dhe përcakton detyrat kryesore për të ardhmen.

**10.2** Kongresi mbledhet një herë në tre vjet . Ai mund të mbledhet më përpara si dhe të shtyhet me kërkesën e 3/5 e antarëve të Këshillit me një maksimum prej nje viti.

Kandidaturat për kryetar të Partisë përcaktohen nga këshilli dhe kanë mbështetjen e jo më pak së e 1/3 të antarëve të këshillit.

**10.3** Një Kongres i jashtëzakonshëm mund të mbledhet ,në situata të vecanta të krijuara, me nismen e jo më pak se me 1/3 e antarëve të Partisë, ose 3/5 e antarëve të Këshillit. Për kongresin e jashtëzakonshëm delegatët janë po ata të kongresit të fundit. Këshilli vendos vendin, datën, rendin e ditës dhe regulloret e Kongresit të Jashtëzakonshëm dhe përcakton komisionin e zhvillimit te punimeve te Kongresit. Kur Kongresi i jashtëzakonshëm duhet të zgjedh kryetarin administrimi i kandidaturave bëhet si në rastin e Kongresit normal.

**10.4** Kongresi mbledhet me vendim të Këshillit i cili vendos vendin, datën, rendin e ditës dhe regulloret e Kongresit. Mbledhja e kongresit dhe rendi i ditës lajmërohen te pakten tre muaj me parë

### **Neni 11**

#### **11.2 Kongresi duhet të vendos :**

- Miratimin e Programit të Partisë.
- Ndryshimet e Statutit të Partisë.
- Parimet udhëzuese të Partisë.
- Zgjedh Këshillin drejtues të Partisë(K.P.D)
- Kryetarin e Partisë.
- Likudimin e Partisë

#### **Kongresi konsiston :**

**a.** Me të drejta të plota votimi :

***Delegatët e zgjedhur nga Konferencat e degëve të Partisë.***

**b.** Pa te drejte votimi :

***Të ftuarit.***

Antarët e Këshillit dhe Deputetët e Partisë që nuk Zgjidhen delegate.

- c. Delegatet për në Kongres zgjidhen nga Konferencat e Partise në Qarqe. Norma e përfaqësimit vendoset nga Këshilli i Përgjithshëm Drejtuesi Partisë, në bazë të numrit të antarëve që ka cdo degë dhe të votave të fituara proporcionalisht në zgjedhjet e fundit para zhvillimit të kongresit.
- d. Votimi zhvillohet me 2/3 e mazhoritetit të delegateve prezente dhe votues. Për ndryshimin e statutit kërkohet një mazhoritet i të deleguarëve prej 3/4
- e. Te gjitha rregulloret e kongresit vendosen nga Këshilli sipas Rregullores.
- f. Në Kongrese mund të marrin pjese dhe të ftuar special dhe të deleguar të ftuar, te cilet nuk kanë të drejte votimi.

## **KESHILLI**

### *Neni 12*

**12.1** Numri i antarëve të K.P.D, caktohet nga Kongresi.

Kryetarët e Degëve të Partisë në Qarqe, Kryetari i F.R.GJ, dhe F.G.GJ, bëhen drejtpërdrejtë antarë të K.P.D.

### **12.2 K.P.D, midis dy Kongreseve të Partisë:**

- Organizon gjithë punën dhe veprimtarinë e P.GJ.
- Përfaqëson P.GJ, në marrëdhëniet me Partitë e tjera, me organizmat, shoqatat e institucionet brënda dhe jashtë vendit.
- Përgjigjet për veprimtarinë ekonomike e financiare të Partisë.
- Organizon e drejton institucionet qëndrore të Partisë dhe shtypin e saj.
- Nxjerr dhe miraton Rregullon si edhe udhëzime të posacme për praktikën e funksionimit, organizimit dhe dokumentimit të veprimtarisë së Partisë.
- Përpunon politikën e përmiresimit të strukturave të Partisë dhe aftësimin e të zgjedhurve në to.
- Miraton dhe kontrollon shpërndarjen e mjeteve materiale e financiare të Partisë.
- Për çështje të rëndësishme të politikës së Partisë ,në periudhën midis dy kongreseve, mbledh Konferencën Kombëtare të Partisë.
- Kur e vlereson të nevojshem mbledh Aktivin Kombëtar të Partisë.
- Krijon komisione të përherëshme dhe të përkohshme pune me antarë të Partisë e përkrahës të saj, për të studiuar dhe zgjidhur probleme teorike, praktike e organizative.
- Miraton programin elektorale të Partisë
- Miraton listën e kandidatëve për deputet dhe renditje në listës shumëemore.
- Vendos për struktura organizative koordinuese në bazë Qarku dhe zonë elektorale.
- K.P.D, zgjedh me votim të fshehtë Kryesinë. Sekretarin e Përgjithshëm dhe Sekretariatit. Numri i antarëve të Kryesisë përcaktohet nga K.P.D . Numri i Sekretarëve përcaktohet nga K.P.D sipas përgjegjësive që do të mbulojnë.
- Cakton Komitetin Ndërmjetes.
- Kopton antarë të rinjë të Këshillit me një mazhoritet prej 2/3;
- Aprovon stafin, buxhetin, llogarinë dhe rregullimet e thesarit pasi ka dëgjuar Komitetin Financiar.
- Përpilon Rregulloren



**12.3** Të gjitha votat brenda Këshillit zënë vënd me 2/3 e mazhoritetit të votave të votuesve prezente.

**12.4** Procedurat e votimit të organeve drejtuese që zgjedh KPD përcaktohen me një vendim të veçantë të tij.

KPD i zhvillon punimet e tij në bazë të Rregullores së KPD, e cila hartohet nga Kryesia e tij dhe miratohet nga KPD.

**12.5** Në mbledhjen e KPD kanë të drejtë të marrin pjesë edhe deputetet e Partisë që s'janë antarë të Këshillit, të cilët kanë të drejtën e fjalës dhe të propozimeve.

**12.6** Këshilli mblidhet si rregull ,një herë në tre muaj,por jo me rrallë se një herë në gjashte muaj , me kërkesën e Kryesisë së Partisë , të Kryetarit të P.GJ,ose të jo më pak se 1/3 të antarëve të tij.

**12.7** Pranë K.P.D të Partisë dhe K.D të Qarqeve, sipas mundësive financiare, krijohen struktura politike e administrative,veprimtaria e të cilave ka karakter ,përkatësisht konsultativ dhe teknik.

## **KRYETARI**

### *Neni 13*

**13.1** Kryetari i PGJ, është drejtuesi kryesor politik dhe administrativ i Partisë, i cili është përgjegjës për drejtimin dhe koordinimin e veprimtarisë së përditshme të Partisë në zbatim të linjes politike të caktuar nga Kongresi dhe Forumet drejtuese të Partisë, të Statutit dhe Rregulloreve të ndryshme.

### **13.2 Kryetari i PGJ, ka këto kompetenca kryesore:**

- Thërret dhe drejton mbledhjen e Kryesisë dhe K.P.D.
- Propozon në K.P.D antarët e rinjë që do të zgjidhen.
- Sekretariatit
- Koordinon e drejton punën me sekretariatit
- Propozon në Kryesi dhe K.P.D, masa të veçanta në zbatim të Statutit.

## **KRYESIA E KËSHILLIT TË PËRGJITHSHËM DREJTUES.**

### *Neni 14.*

### **14.1 Kryesia ka këto kompetenca:**

- Zbaton vendimet e organeve drejtuese qëndrore (Kongresit, dhe Këshillit të Përgjithshëm Drejtues.)
- Përpunon qëndrimet politike,organizon dhe drejton veprimtarinë e përgjithshme të Partisë.
- Ndhmon dhe kontrollon organet drejtuese të Partisë në Qark e zona,për zbatimin e vendimeve të organeve qëndrore(Kongresit Konferencës dhe K.P.D.)
- Shqyrëton kundërshtimet e antarëve dhe seksioneve të Partisë ndaj vendimeve të organeve drejtuese lokale ose qëndrore.
- Vendos për struktura e administës të K.P.D,të institucioneve të tjera qëndrore të Partisë dhe Këshillave Drejtuese të degëve në Qarqe.

- Nxjerr udhëzime në përputhje me statutin e Partisë në zbatim të vendimeve që merren në Kongres dhe në mbledhjen e K.P.D,të Partisë.
- Mund të propozojë në Konferencën e Degës së Partisë të Qarkut kandidaturën për Krytarin e Partisë së Degës së Qarkut.
- Mund të sygjeroj pranë K.P.D të Degës së Partisë të Qarkut zëvendësimin e Kryetarit ose drejtuesëve të tjerë të Degës së Partisë së Qarkut,për dobësi të theksuara në punë ose për arsye të tjera të argumentuara.

Kryesia e Këshillit të Përgjithshëm Drejtues, në frymën e normave të këtij Statuti dhe për të organizuar më së miri funksionimin e saj në ekip, përcakton ndarjen e punëve e të Sekretarëve që ndjekin zbatimin e përditëshëm të detyrave dhe për antarët e tjere të saj.Ky organizim përcaktohet në rregulloren e brëndëshme dhe për të informohet K.P.D i Partisë.

Kryesia e Këshillit të Përgjithshëm Drejtues Mblidhet si rregull një herë në muaj,por jo me rralle se një herë në tre muaj.

## **FORUMI I RINISË SË GJELBËR**

*Neni 15.*

**15.1 F.R.GJ, është organizim politik brënda strukturave të P.GJ.i cili bashkon të rinjë dhe të rejat antarë të P.GJ.**

**15.2** Në F.R.GJ,mund të antarësohen të rinjë dhe të rejat nga mosha 17 deri në 30 vjec.

**15.3** Programi dhe veprimtaria e tij përputhen në përmbajtje me Programin dhe Statutin,veprimtarinë e P.GJ,në tërësi.

**15.4** F.R.GJ,ka përfaqësuesit e propozuar prej tij,në të gjitha organet drejtuese lokale e qëndrore të P.GJ.Norma e përfaqësimit e propozuar prej tij,në të gjitha organet drejtuese është në raport me vendin që ai zë në efektivin e Partisë në tërësi.

## **E DREJTA PËR TË FOLUR DHE PËR TË VOTUAR**

*Neni 16*

E drejta për të folur dhe për të votuar në Parti nuk janë të kufizuara nga mandate urdhëruese.

Pesonaliteti dhe dinjiteti i antarit të Partisë janë të pacënueshëm brënda Partisë.

Demokracia e brëndëshme në Parti është parim bazë dhe organizativ i ekzistencës dhe zhvillimit të saj.

Liria e zgjedhjes dhe votimi i fshehtë janë individuale dhe të garantuara.

## **PËRFAQËSITË LIGJORE**

*Neni 17*

Këshilli është ligjërishit përgjegjës për veprime të Partisë brënda limiteve të përcaktuara nga statuti i saj.

Kryetari, sekretarët dhe sekretari i thesarit veprojnë si përfaqësues ligjor të Partisë duke nënshkruar në emër të Partisë brënda hapsirave që i lejon statuti i saj.

## **KOMISIONET DHE GRUPET E PUNËS**

### ***Neni 18.***

Kryesia dhe Këshilli janë titulluar për të vendosur komisione përpanente dhe grupe pune ad hoc. Raportet dhe propozimet do të nënshtrohen Kryesisë dhe Këshillit për aprovim.

## **KUORUMI**

### ***Neni 19***

Për të gjitha mbledhjet e çdo organi të Partisë apo komisioni, Kuorumi duhet të jetë mbi 50% i të gjithë pjesëmarrësve, derisa të parashikohet ndryshe në rregullore dhe statut.

## **STAFI, THESARI DHE BUXHETI**

### ***Neni 20***

**a.** Rregullorja përcakton detyrat që i përkasin stafit, thesarit dhe buxhetit.

**b.** Antarët e partisë që nuk plotësojnë angazhimet e tyre financiare humbin të drejtën e votimit.

## **MJETET FINANCIARE**

### ***Neni 21***

Burimet financiare të Partisë sigurohen nga mbledhja rregullisht e kuotave të antarëve të Partisë, dhurime dhe kontibute të tjera të ndryshme në përputhje të plotë me ligjin e Partive Politike.

Masa e kuotave të antarësisë si dhe mënyra e mbledhjes së tyre përcaktohet nga K.P.D i Partisë.

Sekretari i thesarit në marreveshje me Kryesinë, projektin buxhetin dhe procedurat financiare, që duhet të aprovohen nga Këshilli. Thesari mbikqyr buxhetin e Partisë dhe i raporton Kryesisë një herë në tre muaj.

Kryesia është përgjegjëse për manaxhimin e zërit financiar të Partisë.

Si trup këshillues për Kryesinë dhe Këshillin për sa i përket stafit të buxhetit dhe çështjeve të thesarit Këshilli cakton një Grup Monitorues Financiar .

Llogaria e Partisë auditohen për çdo vit.

Veprimtaria ekonomike dhe financiare e Partisë shtrohet për shqyrtim jo më rrallë se një herë në vit në mbledhjen e Keshillit të Përgjithshëm Drejtues dhe më shumë se një herë në vit në mbledhjet e Kryesisë së tij.

## **BARAZIA GJINORE**

### ***Neni 21***

Partia e Gjelbër nxit dhe kurajon pjesëmarrjen e femërave dhe meshkujve në të gjitha nivelet politike. Ajo do të bëjë të gjitha përpjekjet që nivelet e përfaqësimit për femrat të jenë 50%.

Parimi i saj i përgjithshëm është që të zgjedhurve në strukturat e saj drejtuese, politike dhe përfaqësuese të kemi një nivel përfaqësimi 50% +1, duke i dhënë gjithmonë prioritet gjinisë femërore.

## **RREGULLORJA**

### ***Neni 22***

Me sygjerimin e Kryesisë, Këshilli do të votojë mbi urdhërat dhe për çdo ndryshim të tyre.

## **KOMITETI NDËRMJETES**

### ***Neni 23***

Këshilli mund të caktoj një Komitet Ndërmjetës, i cili duhet të zgjidh konflikte që lindin midis personave dhe organeve drejtuese të Partisë mbi statutin dhe çështjeve të rregulloreve.

Vendimet e marra nga Komiteti Ndërmjetës u dërgohen të gjithë personave dhe organeve të Partisë.

## **FORUMET JO PARTIAKE**

### ***Neni 24***

Të Gjelbërit mbështesin bashkëpunimin, në rradhë të parë me Forumin e Grave të Gjelbëra, me sindikatat, shoqatat dhe çdo organizëm tjetër të ligjshëm që shpreh e mbrojnë interesat e antarëve të vet sipas parimeve themelore të Demokracisë dhe ekokohësimit.

## **SIMBOLI I PARTISË**

### ***Neni 25***

20. Simboli i PGJ, paraqet një luledielli. Poshtë saj janë shkruar fjalët Partia e Gjelbër. Ky simbol vendoset në vulën, në stemën dhe në flamurin e Partisë.

## **LIKUIDIMI I PARTISË**

### ***Neni 26***

Likuidimi i Partisë duhet të vendoset me një mazhoritet prej 3/4 të të gjithë antarëve të Partisë. Shkaqet dhe arsyet e likuidimit janë parashikuar nga ligji i krijimit të Partive Politike. Në rast likuidimi të Partisë shlyhen të gjitha detyrimet që ka Partia, mjetet financiare që mbeten i dërgohen ndonjë fondacioni.